



Republika e Kosovës
Republika Kosovo – Republic of Kosovo
Kuvendi – Skupština – Assembly

Legjislatura VIII

Sesioni pranveror

Komisioni për Ekonomi, Industri, Ndërmarrësi dhe Tregti

Mbledhja nr. 66/2022

Prishtinë, më 12.7.2022, në orën 11:00

Ndërtesa e Kuvendit, salla N-10

P R O C E S V E R B A L

Në mbledhje morën pjesë: Ferat Shala, kryetar, Mimoza Kusari-Lila, Armend Muja, Driton Hyseni, Gramos Agusholli, Valentina Bunjaku- Rexhepi dhe Pal Lekaj, anëtarë.

Munguan: Jeta Statovci, nënkryetare e parë, Fidan Jilta, nënkryetare e dytë, Abelard Tahiri dhe Ljubinko Karaxhiq, anëtarë.

E ftuar: znj. Neime Binaku - Isufi, kryetare e Komisionit për Mbrojtjen e Konkurrencës (AKRK).

Pjesëmarrës tjerë: Sakip Imeri, drejtor i Përgjithshëm i Sekretariatit të Autoritetit, dhe Etrit Tetova, shef i divizionit të analizës, AKRK; Reshat Nurboja, Kuvendi; Doresa Deliu, KDI; Egzona Tërdevci, GPLVV; Festim Bytyçi, GPAAK; Duresa Tafa, Kuvendi/media; dhe mediat.

Stafi mbështetës i Komisionit: Armend Ademaj, Muhamet Morina, Veton Raci dhe Denis Berisha (praktikant D+).

Mbledhjen e kryesoi z. Ferat Shala, kryetar i Komisionit.

Rendi i ditës:

- 1. Miratimi i rendit të ditës;**
- 2. Miratimi i procesverbalit nga mbledhja e mbajtur më 28.06.2022;**
- 3. Shqyrtimi i Raportit vjetor i Autoritetit të Konkurrencës të Republikës së Kosovës – AKRK për vitin 2021;**
- 4. Të ndryshme.**

Kryetari konstatoi se janë plotësuar kushtet për fillimin e punës së komisionit dhe e hapi mbledhjen.

1. Miratimi i rendit të ditës

Rendi i ditës u miratua pa ndryshime.

2. Miratimi i procesverbalit të mbledhjes së mbajtur më 28.6.2022

Procesverbali, i mbledhjes së mbajtur më 28.6.2022, u miratua pa vërejtje.

3. Shqyrtimi i Raportit vjetor i Autoritetit të Konkurrencës të Republikës së Kosovës – AKRK për vitin 2021

Kryetari, theksoi se në bazë të nenit 72, të Rregullores së Kuvendit, dhe në pajtim më Ligjin për mbrojtjen e konkurrencës, sot kemi në shqyrtim raportin vjetor të Autoritetit të Konkurrencës të Republikës së Kosovës – AKRK për vitin 2021. Një Memo e keni marrë nga stafi, që analizon këtë raport. Në fillim po ia kaloj fjalën kryetares së Komisionit të Konkurrencës dhe mandej hapim debat.

Znj. Neime Binaku - Isufi, kryetare e Komisionit për Mbrojtjen e Konkurrencës, fillimisht përshëndeti deputetët dhe të pranishmit tjerë në takim, dhe potencoi se siç e dini Kuvendi i Republikës së Kosovës më 14.06.2022 ka nxjerrë vendim për emërimin e anëtarëve të Komisionit për Mbrojtjen e Konkurrencës. Misioni ynë është të zhvillojmë aktivitete në krijimin e kushteve që tregjet të ofrojnë përfitimet për konsumatorët, bizneset dhe shoqërinë në tërësi, duke mbrojtur konkurrencën në treg dhe duke promovuar një kulturë të konkurrencës në të gjithë Republikën e Kosovës. Autoriteti i konkurrencës vepron kur cenohet ose shtrembërohet konkurrenca në treg. Më konkretisht Autoriteti reagon në ato raste kur ndërmarrjet veprojnë në mënyrë të koordinuar përmes formës së kartelit, marrëveshjes së ndaluar apo sjelljeve të tyre në treg. Autoriteti mund të reagojë edhe ndaj ndërmarrjeve që kanë pozitë dominuese në treg dhe të cilat keqpërdorin këtë pozitë. Autoriteti ka në mandatin edhe për trajtimin e përqendrimeve të ndërmarrjeve. Të gjitha format që konsiderohen kufizim apo shtrembërim i konkurrencës në tregjet përkatëse nga operatorët ekonomik që veprojnë në këto tregje do të jenë objekt i shqyrtimit nga Autoriteti. Është java e tretë që e kemi marrë mandatin dhe për prezantim të raportit ia kaloj fjalën drejtorit të Përgjithshëm të Autoritetit z. Sakip Imerit.

Kryetari theksoi se ju uroj sukses në punë, në këtë kohë kur rrethanat janë që me pasur punë më shumë për shkak të rrjedhave dhe zhvillimeve ekonomike dhe inflacionit. Kemi pritur se do të kemi më shumë anëtarë të komisionit të konkurrencës sot në raportim.

Mimoza Kusari- Lila theksoi se fillimisht ju urojë punë të mbarë dhe suksese si komisioni i ri i konkurrencës. E nderuar kryetare e komisionit të konkurrencës anëtarët tjerë nuk mundën me liruar vetën nga raportimi në Komision në Kuvend. Ky Komision është autoriteti të cilit ju i raportoni, përmes të cilit raportohet në Kuvend për punën dhe performancën e juaj. Nuk duhet të ketë angazhim më të rëndësishëm për ju sesa ardhja në raportim në Kuvend. Ky është raportimi vjetor dhe duhet të jenë në raportim të gjithë anëtarët e komisionit të konkurrencës dhe kjo vlen për të gjitha trupat që i raportojnë Kuvendit.

Sakip Imeri, AKRK, theksoi se në kuadër të aktiviteteve të vitit 2021 Autoriteti i Konkurrencës ka trajtuar 17 raste, ka monitoruar 8 tregje, përfshirë tregun e çimentos, tregun për produktet grurë, miell, gaz, naftë, benzinë, sheqer, vaj dhe transport. Po ashtu ka zhvilluar monitorimin në tregun e shitjes me pakicë në sektorin e shëndetësisë, posaçërisht te laboratorët e licencuar për testim “Sars Covid 19”, monitorimin e sektorit të radiotaksive, monitorimin e produktit të vajit të lulediellit, monitorimin e berberëve në Komunën e Kaçanikut, Rahovecit, Mitrovicës dhe Pejës, gjithashtu monitorimin e sektorit të gastronomisë në Komunën e Prishtinës, Mitrovicës dhe Gjilanit. Janë bërë përgatitjet për dy analiza të sektorit financiar bankar dhe për sektorin e shëndetësisë. Gjatë vitit 2021 janë pranuar 10 kërkesa për përqendrime prej të cilave dy janë miratuar nga janë miratuar nga komisioni i konkurrencës, ndërsa 8 tjerat konsiderohen miratuara për shkak të mungesës së komisionit konkurrencës sepse brenda 30 ditëve nuk është marrë vendim për ato kërkesa. Për këtë edhe nuk janë realizuar të hyra për këto 8 përqendrime. Gjatë vitit 2021 Autoriteti ka filluar procedurë hetimore për ndërmarrjet KEDS dhe KESCO të cilat operojnë në tregun e energjisë elektrike. Hetimi ndaj këtyre ndërmarrjeve është autorizuar nga Komisioni për Mbrojtjen e Konkurrencës dhe vjen si rezultat i një studimi të detajuar të tregut të energjisë në Kosovë. Numri i ankesave të qytetarëve gjatë vitit 2021 ka shënuar rënie krahasuar me 2020. Janë trajtuar me kujdes dhe profesionalizëm. Autoriteti ka arritur memorandume bashkëpunimi me ATK dhe me dy universitete, me UBT dhe me AAB. Gjithashtu janë realizuar trajnime të stafit në IKAP dhe Ministrinë e Financave. Pjesa e parë e vitit 2021 ka shënuar një aktivitet në rritje të Autoritetit në fushën e legjislacionit përmes grupit punues për hartimin e ligjit të ri për mbrojtjen e konkurrencës, si dhe legjislacionit sekondar. Edhe vitin 2021 e ka shoqëruar vështirësia e shkaktuar nga pandemia Covid 19 me mbyllje të herë pas hershme në punë dhe kufizime të stafit të Autoritetit. Gjatë pandemisë shumë ndërmarrje është dashur të bashkëpunojnë me njëra tjetrën në magazinim, logjistikë, transport. Autoriteti përkrahet nga projekti i IPA 2017 i financuar nga BE-ja.

Kryetari pyeti se a është kompletuar Komisioni për Mbrojtjen e Konkurrencës, sepse sa kam kuptuar dy prej anëtarëve kanë pasur marrëdhënie pune, dhe si kanë vepruar a mund të na jepni ndonjë informacion, sepse për kjo çështje duhet të përmbyllet, kërkojmë të kemi një përgjigje zyrtare nga ju për këtë çështje?

Neime Binaku -Isufi, AKRK, sqaroi se për dy anëtarë po presim sqarimet zyrtarisht, mirëpo Komisioni i konkurrencës është kompletuar me 3 anëtarë dhe ka mundësi të marrë vendime. Sot do ta kemi informacionin zyrtar për këtë çështje.

Armend Muja pyeti se monitorimi i tregut në shërbimet financiare bankare qe sa ka filluar, a ka një konkluzion për këtë? Po ashtu na duhet një konkluzion edhe për procedurën hetimore për KEDS dhe KESCO?

Sakip Imeri, AKRK, sqaroi se në nëntor 2020 ka filluar monitorimi në sektorin financiar bankar. Kemi marrë informata nga të gjitha bankat komerciale, presim që deri në nëntor 2022 të përmbyllet procesi. Hapja e hetimit për KEDS dhe KESCO ka ardhur pas analizimit të tregut të shërbimet e përbashkëta. Te rezultatet nuk mundemi me konstatuar derisa të përfundojë hetimi.

Armend Muja kërkoi që rezultatet e hetimit të thelluar të ndahen me deputetët. Te përqendrimi, tek importi dhe përpunimi i miellit, për vitin 2021 keni gjetur se kemi një përqendrim prej 78% te një kompani e vetme që quhet Aroma shpk. A konsideroni ju se ekziston mundësia që të mbizotërojë interesi i një kompanie mbi interesin e konsumatorëve?

Sakip Imeri, AKRK, sqaroi se çdo treg që ka pozitë dominante është një sinjal për Autoritetin që të thellojë monitorimin dhe ta ketë në monitorim të vazhdueshëm për shkak se ajo pozitë dominuese mund të krijojë edhe deformime në treg.

Armend Muja pyeti se a do ta monitoroni këtë vit këtë treg dhe të merrni masa pastaj? Dhe a do të na informoni në baza tre mujore për këtë dhe veprimet që po i merrni?

Sakip Imeri, AKRK, theksoi se sa për informatë janë disa tregje në monitorim të vazhdueshëm nga Autoriteti i konkurrencës. E monitorojmë dhe ju informojmë në baza tremujore.

Armend Muja thotë se të dhënat për grurin në bazë të raportit tremujorit e keni gjetur që ka një koncentrim te kompania MSilloi shpk me treg 60%. A mund të konsiderohet se ka një pozitë dominuese përtej rregullave që i lejon ligji?

Sakip Imeri, AKRK, sqaroi se ligji e lejon pozitën dominuese, por ndalohet abuzimi me pozitën dominuese edhe monitorohet nga Autoriteti.

Armend Muja pyeti se a do ta përcillni tre muajt e ardhshëm këtë kompani duke marrë parasysh ndjeshmërinë e produkteve? Në tregun e vajit dhe naftës ku ka pasur rritje të çmimit a keni marrë ndonjë masë ju për këtë industri nën vështrim të thellë siç e përcakton ligji?

Sakip Imeri, AKRK, potencoi se ligji e përcakton që hetim të thelluar mund të iniciojë vetëm Komisioni për Mbrojtjen e Konkurrencës. Sekretariati e ka mundësinë vetëm monitorimi dhe grumbullimi i fakteve d. m. th. shqyrtimin paraprak, këto veprime i kemi ndërmarrë.

Armend Muja theksoi se te nafta nuk keni gjetur asnjë lloj koncentrimi madje jo thoni se është mjaft mirë edhe te nafta edhe te gazi tregu i diversifikuar. A keni nxjerrë ju një vendim në 2020 që i dënoni pikërisht këto kompani të naftës për shkak të abuzimit që ka ndodhur në të kaluarën, a është zbatuar ai vendim?

Sakip Imeri, AKRK, potencoi se për vendimin e Autoritetit të konkurrencës nuk janë paguar mjetet, për shkak se Autoriteti është paditur për atë vendim nga kompanitë. Kanë qenë në hetim 16 kompani, 14 nga të cilat janë dënuar me 4.1 milionë euro, dhe pastaj ne e kemi monitoruar ndikimin e atij vendimi dhe ka pasur diferenca në çmime që nuk ka qenë karakteristikë e periudhës kur janë hetuar.

Armend Muja kërkoi që të gjitha të dhënat të i ndani me neve për të gjitha sektorët, përfshirë tregun e sistemit bankar, tregun e sigurimeve, edhe të gjitha konkluzionet që i keni me KEDS-in dhe KESCO-n.

Driton Hyseni theksoi se do të flasë për një çështje që lidhet me rritjen e policave të sigurimit të veturave. Kemi 10 kompani që ofrojnë një shërbim të tillë dhe që kanë një dakordim mes tyre sa i takon çmimit që ofrojnë në treg. Banka qendrore si autoritet rregullator i cili ka lejuar ngritjen e çmimit ju është drejtuar juve si Autoritet i konkurrencës me kërkesë që të marrë një vendim profesional nga ana e juaj. Ju e keni dhënë mendimin profesional, BQK është njoftuar me këtë mendim profesional. Në raportin për 2020 patët theksuar se BQK ka thënë se së shpejti do të ketë liberalizim të tregut dhe do të vendoset një çmim tavan dhe një çmim dysHEME për të gjithë ofruesit e shërbimeve të sigurimit të veturave. Në këtë raport nuk keni diçka rreth kësaj çështje. Çfarë ka bërë Autoriteti i konkurrencës për këtë çështje që të kemi liberalizim të tregut të sigurimeve të veturave, a jeni duke e përcjellë këtë situatë, sepse asgjë nuk ka ndodhur që nga viti 2019, që nga kjo kohë qytetarët paguajnë 26% më shumë?

Etrit Tetova, AKRK, potencoi se ka qenë zotim publik i dy udhëheqësve, kryetarit dhe anëtarit të BQK-së që në janar 2021 të fillojë me liberalizimin e tregut të sigurimeve dhe deri tani nuk asnjë lëvizje në atë drejtim.

Driton Hyseni pyeti se a ka hapësirë ligjore të merrni masa ligjore për BQK-në?

Sakip Imeri, AKRK, sqaroi se ka pasur rekomandim prej Autoritetit se si do të vjen deri te çmimi që i përcaktojnë aktuarët, por aktuarët nuk duhet të caktojnë në mënyrë të koordinuar por në mënyrë individuale aktuarët e secilës kompani të sigurimeve përcaktojnë çmimet pastaj BQK-ja është organi që e miraton çmimin, qoftë çmimin gjysmë të liberalizuar ku do të ketë tavan edhe dysHEME ose çmimin fiks çfarë e ka përcaktuar.

Driton Hyseni pyeti se a keni informata për metodologjinë e caktimit të çmimit të policave të sigurimit të veturave? Ju inkurajoj që këtë çështje ta merrni me prioritet. E keni paraqitur në raport se gjatë kohës së pandemisë ka pasur bashkëpunim mes kompanive. Ngritja e çmimeve gjatë pandemisë, a keni mundur me vërejte nëse ka ardhur si rezultat i këtij bashkëpunimi mes kompanive?

Sakip Imeri, AKRK, sqaroi se bashkëpunim për rritje të çmimit nuk ka pasur. Bashkëpunimi më i madh ka qenë në fushën e transportit për shkak të masave të pandemisë. Ne kemi kryer analizën e tregut të vajit të lulediellit dhe kemi gjetur se përkundër rritjes së çmimit, marzha e fitimit ka pasur rënie. Jo detyrimisht mund të fillohet hetim nga ngritja e çmimeve në produkte të ndryshme.

Driton Hyseni theksoi se sipas raportit fondet e IPA janë shpenzuar edhe për takime me ZRRE, pse janë shpenzuar për takime, sa janë fondet e IPA për Autoritetin? Ndiheja e fondeve të IPA a ka ndikuar në ngritjen e kapaciteteve të Autoritetit? Po ashtu sfidë nuk duhet të jetë hetimi i paparalajmëruar?

Sakip Imeri, AKRK, sqaroi se fondi i IPA është afërsisht 3 milionë euro në konkurrencë dhe ndihmë shtetërore. Fondi menaxhohet nga projekt e jo nga Autoriteti. Kjo periudhë ka qenë më e mira deri tani për ngritje të kapaciteteve të Autoritetit. Janë 3 institucione kryesore për bashkëpunim, me ARKEP, ZRRE, BQK. Kemi arritur të mbajmë trajnime nga fusha e ARKEP, ZRRE, BQK, edhe me gjyqësorin kemi pasur trajnime. Sfidë ka qenë kontrolli i paparalajmëruar

sepse nuk është ditë cila gjykatë me marrë vendim për kontroll të paparalajmëruar. U tejkalua kjo sfidë. Nuk ka pasur asnjë rast të vetëm të kontrollit të paparalajmëruar.

Etrit Tetova, AKRK, theksoi se me ligjin e ri e kemi që edhe me vetiniciativë me trajtuar rregulloret dhe aktet tjera të institucioneve publike.

Kryetari potencoi se moszbatimi i vendimit të mëhershëm të Komisionit të Konkurrencës lidhur me kompanitë e sigurimit duhet të trajtohet nga ju, dhe nuk duhet të jeni inferior nga moszbatimi i tij. Mos paraqitja në raport e këtij rasti me BQK-në lidhur me kompanitë e sigurimeve nuk është qasje e mirë dhe mund të nënkupton edhe mos përmbushje e detyrave në përcjelljen me kontinuitet të vendimeve të juaja. Ne duhet ta kemi një qëndrim të juajin për zbatimin e opinionit të Autoritetit nga BQK-ja lidhur me tregun e sigurimeve të automjeteve.

Pal Lekaj fillimisht uroi kryetaren e Komisionit të konkurrencës për përzgjedhje dhe theksoi se tregu ka vështirësi, konkurrenca ka vështirësi, dhe për t'u mbikëqyrur kërkohet edhe vullnet edhe guxim. Ne kemi në Kosovë industri të re, siç janë kriptovalutat, cili është veprimi i juaj sa i përket tregut të ri të kriptovalutave? Kemi miratuar ligjin për markat tregtare, sa do të jetë i implementueshëm, cili do të jetë roli i juaj? Sa i përket kapaciteteve njerëzore, keni kërkuar një zyrtar të lartë. Si do t'i qaseni plotësisht të kësaj kërkesë? Po ashtu keni thënë se sfidë është pavarësia buxhetore. Çka keni menduar, a po ju mungon buxheti, apo ka ndonjë problem tjetër? Sa nga fondi i IPA kanë shkuar me juve si Autoritet i konkurrencës?

Sakip Imeri, AKRK, theksoi se sa i përket tregut të kriptovalutave si autoritet ende nuk kemi ndonjë veprim të autoritetit në këtë drejtim, ende nuk është rregulluar as në shumicën e vendeve të Evropës. Ligji për markat tregtare mund të ndikojë në veprimet e autoritetit sepse mund të ketë keqpërdorime të markave tregtare që mund të krijojnë çrregullime në treg, dhe në këto situata autoriteti do të reagojë. Sa i përket stafit, vërtetë kemi staf të munguar, për një pozitë të lirë jemi në proces të rekrutimit. Kërkesa është për shtatë zyrtarë. Ne nuk e kemi zërin e investimeve kapitale, sikur ta kishim do të na mundësonte të marrim programe softwerike që do ta rritnin efikasitetin e punës së Autoritetit. Prandaj duhet të na lejohen investimet kapitale. 14 punëtorë janë profesional, ndërsa gjithsejtë janë 23 duke përfshirë edhe anëtarët e Komisionit të Konkurrencës.

Driton Hyseni lidhur me memorandumet pyeti pse nuk ka memorandume me universitetet publike por vetëm me UBT dhe AAB? Kërkojmë që të jeni të hapur për universitetet publike.

Sakip Imeri, AKRK, theksoi se ka pasur iniciativë me Universitetin e Mitrovicës por nuk është nënshkruar ende memorandumi. Pastaj edhe mungesa e Komisionit ka ndikuar që mos të ketë nënshkrime të memorandumeve. Memorandumet janë të karakterit bashkëpunues lidhur me shkëmbim të informacionit, organizim të ligjëratave, qasja për punime shkencore, ofrimi i praktikës për studentët në Autoritetin e Konkurrencës.

Armend Muja theksoi se tregu i telekomunikimeve, ka pasur studime, ku theksohen se këto tregje janë të ekspozuara ndaj rrezikut të përqendrimit. Në bazë të raportit të ARKEP-it del që Artmotion është në ekspansion shumë të shpejtë, që është në rregull nëse do të bëhej për shkak të sinjalit, eficiencës, por neve na vijnë informata se ka një marrëveshje mes Kujtesës, Artmotion

dhe IPKO-s, a dini ju diçka për këtë treg, a keni bërë studime për këtë çështje, sepse kjo marrëveshje rrezikon me shkatërruar tërë tregun mediatik, dhe krijon një pozitë dominante e cila duhet të monitorohet? Po ashtu për MTS ka 21% të internetit, ndërsa 6% në Telekom. Duhet me studiuar internetin nga MTS. Të na informoni nëse keni diçka informata për këtë çështje.

Sakip Imeri, AKRK, sqaroi se me ARKEP-in e kemi një grup pune të përbashkët për këto çështje. Tash e kemi Komisionin e konkurrencës dhe e kemi më lehtë të veprojmë.

Pas debatit, komisioni, me 4 (katër) vota “për” dhe 2 (dy) “abstenim”, nxori këtë:

Përfundim

- 1. I rekomandohet Kuvendit të miratojë raportin vjetor të Autoritetit të Konkurrencës të Republikës së Kosovës - AKRK, për vitin 2021;*
- 2. Raporti të procedohet në Kuvend sipas procedurës së paraparë me Rregullore të Kuvendit.*

4. Të ndryshme

Takimi me delegacionin nga Teksasi, SHBA

Kryetari, rikujtoi deputetët se nga ora 13:00 presim në takim një delegacion nga Teksasi i SHBA, i cili përmes takimeve me biznese dhe institucione synon promovimin e teknologjive Amerikane për 4G dhe 5G, ngritjen e vetëdijes mbi rreziqet që vijnë nga teknologjitë jomiqësore, si dhe hapjen e derës për investime nga bizneset e Teksasit në Kosovë.

Mbledhja përfundoi në orën 12:30.

E përgatiti: Stafi mbështetës i Komisionit

Ferat Shala,

Kryetar i Komisionit